



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:182880
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06252584

2024:182881

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit N.A, me vendbanim në rrugën "...", Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.Nr.932/24, të datës 27.06.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani si dhe të pandehurit N.A, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 23.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

N.A, i lindur më në Ferizaj, me vendbanim në rrugën "...", Komuna Ferizaj nga i ati K..... dhe nëna H....., e gjinisë Ç....., me numër personal, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 12.06.2024, rreth orës 21:30, në rrugën “....”, në Ferizaj, përkatësisht në marketin “.....”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që fillimisht hyn në market dhe në shportën e dorës i vendos 3 pako çokollata të llojit “Snickers”, në shportë për bartje dhe pasi që sigurohet se askush nuk po e shikon në një pjesë tjetër të marketit ulet dhe i fut në çantën e shpinës dhe me të vërejtur nga kamerat e sigurisë në dalje të marketit i pandehuri është ndaluar nga punëtorët e sigurimit, me ç ‘rast të dëmtuarës i shkakton dëm material në vlerë prej 42 euro.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2, të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe neni 313, paragrafi 2 të KPRK-së dhe neneve 364 , 449 , 462, të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej 200 € dyqind euro/, të cilin dënim është i obliguar të e paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pasi që Aktgjykimi të e merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 paragrafi 3, të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do të i llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

E dëmtuara market “.....” në rrugën “....”, në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP/II.Nr.932/24, e datës 27.06.2024, e ka ngarkuar të pandehurin N.A, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.09.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Ismet Rrahmani si dhe i pandehuri N.A.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar

Në shqyrtimin fillestar të datës 23.09.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 paragrafi 1, të KPPK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri N.A, me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranojë fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza, është penduar thellë, kërkon falje publike, është i gjendjes së dobët ekonomike, tani ka filluar punën dhe po ashtu ka ndërprerë marrjen e substancave narkotike dhe është duke u trajtuar, premtion se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale si dhe lus gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjyqtaria e vetme gjykuese në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që Prokurori i Shtetit të jap mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase ky pranim i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242, të KPRK-së,

pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, prandaj gjykatës i propozon që këtë pranim fajësie të e aprovoj.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 paragrafi 6, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurit për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si: Raporti i oficerit i dt. 12.06.2024, Raporti i policit hetues me nr. 2024-CF-.....; Raporti fillestar i incidentit i dt.12.06.2024, me nr. të rastit: 2024-CF-....., Deklarata e të pandehurit N.A dhënë ne SP në Ferizaj e datës 12.06.2024, Deklarata e dëshmitarit F.SH dhënë në SP në Ferizaj me datë 12.06.2024, Vërtetim mbi konfiskim të sendeve i datës 12.06.2024, Vërtetim mbi kthim të sendeve i datës 12.06.2024, CD- ja, si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe konstaton se Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjyqtaria e vetme gjykuese konform nenit 242 paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2, të KPRK-së, pasi që i pandehuri me datë dhe vend të caktuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të lujatshme e që vetit të i sjellë përfitim pasur të kundërligjshëm ka hyrë në Marketin “.....”, në Ferizaj, dhe nga aty ka marrë 3 pako çokollata të llojit “Snickers”, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarës në vlerë prej 42 €.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se i pandehuri është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris, ndërsa në rastin konkret si rrethanë rënduese i mori faktin se i pandehuri është person i njohur për gjykatën, është recidivist, është person i dënuar edhe më parë me Aktgjykime të formës së prerë dhe atë Aktgjykimi Pkr.77/18, datë 29.05.2018, Aktgjykimi P.Nr.1608/18, datë 23.05.2019, Aktgjykimi 2023:205379, Aktgjykimi 2023:224854, datë 31.05.2024, Aktgjykimi 2024:031103, datë 17.07.2024, andaj bazuar në të gjitha këto të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet procedurale

E dëmtuara market “.....” në rrugën “...”, në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1, lidhur me nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimin për shumën për Fondin e Kompensimit të viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit 08/L-109.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
2024:182881, datë 25.09.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Lavdije Brahimi-Aliu

Gjyqtarja

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.